

STATUTI I SHOQËRISË TREGTARE
“DEVOLLI LOGISTIC CENTER ALBANIA” SH.P.K.

Në Tiranë, më datë **07 Prill 2025** ditën e hënë u mbledh:

“DEVOLLI LOGISTIC SYSTEM” SH.P.K, me NUI 810867707 me adresë Rruga “Zona Industriale”, Fabrika e Amortizatorëve, Prishtinë, Kosovë, me ortak të vetëm **Z.Shkëlqim DEVOLLI**, me Nr. Pasaporte P01686851.

Neni 1

EMËRTIMI DHE QËNDRA E SHOQËRISË

EMËRTIMI : “DEVOLLI LOGISTIC CENTER ALBANIA” SH.P.K

SELIA: *objekti “Prestige Industrial Park”, pasuria Nr. 174/2, ZK 3974 , Vorë, Tiranë, Shqipëri;*

Shoqëria do të jetë person juridik me regjistrimin në QKB sipas Ligjit Nr.131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe në bazë të Ligjit Nr 9901 të datës 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Shoqëria do të gëzojë të gjithë të drejtat si person juridik dhe do të fillojë veprimtarinë e saj nga data e regjistrimit në QKB.

Shoqëria e ka selinë e saj në Vorë, me adresë: objekti “Prestige Industrial Park”, pasuria Nr. 174/2, ZK 3974 , Vorë, Tiranë, Shqipëri.

Ajo mund të çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe me miratim të organeve kompetente edhe jashtë vendit.

Neni 2

QËLLIMI I SHOQËRISË

Objekti i veprimtarisë të saj do të jetë:

- Tregëtia me shumicë dhe pakicë e kafes, çajit, kakaos dhe erëzave;
- Tregëtia me shumicë jo e specializuar;
- Tregëtia me pakicë në dyqane jo të specializuar, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhar
- Tregëtia me pakicë e tekstileve në dyqane të specializuara;
- Tregëtia me pakicë e luleve, bimëve, farërave, plehrave artificiale, kafshëve përkëdhelëse dhe ushqimi i tyre, në dyqane të specializuara;
- Tregëtia tjetër me pakicë, jo në dyqane, tezga ose tregje;



- Aktivitete të tjera shërbyese të ushqimit;
- Aktivitetet shërbyese të pijeve;
- Tregëtia me shumicë e tekstileve;
- Qiradhënia dhe menaxhim i pasurive të paluajtshme prone ose të marra me qira;
- Hulumtimi i tregut dhe matja e opinionit publik (sondazhet);
- Aktivitetet e tjera shërbyese në mbështetje të bizneseve p.k.t;
- Aktivitetet mbështetëse për shfaqje artistike;
- Aktivitetet e tjera të argëtimit dhe rekracionit;
- Tregëtia e veturave dhe automjeteve me fuqi motorike të vogël;
- Tregëtia e automjeteve të tjera;
- Aktivitete të ndërmjetësimit për shitjen e tekstileve, veshjeve , gëzofit, këpucëve dhe artikujve prej lëkure.

Objekt të veprimtarisë së saj shoqëria do të ketë edhe kryerjen e çdo operacioni ekonomik dhe juridik të lejuar nga legjislacioni shqiptar, që përputhet me objektin e veprimtarisë së saj dhe që kanë rëndësi për të ardhmen e shoqërisë.

Neni 3 REGJIMI JURIDIK I SHOQËRISË

“Shoqëria”, në veprimtarinë e saj bazohet në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Kjo shoqëri tregëtare krijohet me objektivin për të vazhduar veprimtarinë për një periudhë kohore pa afat.

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, mund të ndryshojë regjimin juridik të Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e saj sipas Legjislacionit Shqipëtar.

Në këtë rast Ortakët do ta përshtasin “Kontratën e Themelimit” dhe “Statutin e Shoqërisë”, si dhe regjistrimin e tyre nga organet kompetente Shqiptare.

“Shoqëria” gëzon personalitet juridik nga dita e miratimit dhe e regjistrimit të saj në regjistrin tregëtar në Q.K.B. “Shoqëria” mund të ketë pasuri të luajtëshme dhe të paluajtëshme, në përputhje me dispozitat e Legjislacionit Shqipëtar. Pasuria mbrohet sipas dispozitave të ligjit në fuqi.

“Shoqëria” do të ketë vulën e saj të cilën do ta caktojë me Vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4 TË DREJTA DHE DETYRIME



“Shoqëria” ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj. “Shoqëria” gëzon të drejtën që të bëjë importimin dhe eksportime të nevojshme për realizimin e qëllimeve të saj pa asnjë pengesë. Ajo gëzon të drejtën e caktimit të çmimeve dhe të produkteve të saj që do të disponojë për tregun e brendshëm dhe të jashtëm sipas rregullave të Legjislacionit në fuqi. “Shoqëria” ka të drejtën e vënies (rëndimit) në Hipotekë të pasurisë së saj sipas Legjislacionit në fuqi. Ortakët kanë të drejtë të eksportojnë fitimin jashtë shtetit në valutë, të eksportojë lëndë të parë, produkte dhe shërbime konform Legjislacionit Shqiptar.

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe do të përballojë humbjet deri në kufirin e kontributit të themeluesve të saj në kapitalin themeltar.

NENI- 5 AFATI- VULA

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar dhe fiton personalitetin e saj nga momenti i regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Tiranë. Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje **“DEVOLLI LOGISTIC CENTER ALBANIA” Sh.p.k.**

NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë në shoqëri.

Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga “DEVOLLI LOGISTIC SYSTEM” SH.P.K, me NUI 810867707 me adresë “Zona Industriale”, Fabrika e Amortizatorëve, Prishtinë, Kosovë, me ortak të vetëm Z.Shkëlqim Devolli, me Nr. Pasaporte P01686851, e cila ka formuar kapitalin fillestar të shoqërisë në vlerën prej 50,000 lekë – (pesëdhjetë mijë lekë), me 1 kuotë “DEVOLLI LOGISTIC SYSTEM” sh.p.k ose 100% të kapitalit të shoqërisë.

Te gjithë kuotat e kapitalit themeltar janë të nënshkrueshme dhe të shlyeshme krejtësisht. Çdo kuote i takon e drejta e një vote.

NENI 7

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.



NENI 8

Ortakët mund t'u shesin të tretëve kuotat e tyre të kapitalit pjesërisht ose tërësisht por pasi tua kenë ofruar për blerje ortakëve brenda shoqërisë me kushte jo më pak të favorshme nga ato që j'u ofrohen të tretëve. Oferta u komunikohet me shkrim ortakëve të cilët kanë të drejtën e parablerjes, e drejtë që duhet ta ushtrojnë brenda 30 ditëve nga data e komunikimit.

NENI- 9

Kapitali i shoqërisë do të përbehet nga kapitali themeltar, mjetet e xhiros dhe të tjera të nevojshme të luajtëshme apo të paluajtëshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë.

NENI 10

Heqja dorë nga shoqëria nuk e liron ortakun nga detyrimet e lindura me parë ndaj shoqërisë. Gjithashtu ai gëzon të gjitha të drejtat e lindura para largimit të tij.

NENI 11

ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

- Asambleja e ortakëve.
- Administratori i Përgjithshëm/ Përfaqësuesi ligjor .

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

NENI 12

ASAMBLEJA

Asambleja e ortakëve është organi më i lartë vendimor. Ajo mbledhet sa herë e shohin të arsyeshme ortakët me një quorum prej (60% e votave), por domosdoshmërisht për të miratuar bilancin vjetor të shoqërisë. Asambleja i merr vendimet me 50%+ 1 të votave të përgjithshme.

NENI 13

Asambleja vendos për bilancin vjetor, për ndryshimet në statut, shtimin ose pakësimin e kapitalit, për emërimin e organit administrativ, për drejtimet kryesore të veprimtarisë së shoqërisë, për pushimin apo rritjen e veprimtarisë së shoqërisë.

NENI 14

ORGANI –ADMINISTRATIV

Administrator i Përgjithshëm i shoqërisë “DEVOLLI LOGISTIC CENTER ALBANIA” sh.p.k caktohet Z.DRILON TAHIRI, i lindur në Peje më 01/03/1982,



banues në Peje/Kosovë i identifikuar me ID me nr. 2003664387, për një afat kohor 5 vjeçar, nga data e regjistrimit të shoqërisë në Q.K.B.

Administrator i Përgjithshëm ka të drejtë të administrojë pasurinë e shoqërisë dhe të kryejë veprimet bankare që kanë të bëjnë me llogarinë dhe veprimtarinë e shoqërisë. Ortakët e shoqërisë kanë të drejta e detyrime të barabarta ndaj shoqërisë e ligjeve.

NENI 15

Administrator i Përgjithshëm ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët për përmbushjen e aktivitetit të saj në përputhje me nenin 6 të këtij statuti.

Organi Administrativ (Administratori i Përgjithshëm) është kompetente për të:

- Realizuar mbledhjen e asamblesë duke njoftuar ortakët me shkrim 15 ditë më parë;
- Miratuar planet dhe bilancet periodike mujore dhe tre mujore;
- propozuar strukturën e aparatit të shoqërisë;
- Marrë në punë persona të ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta duke lidhur kontrata pune, qirajë e veprime të tjera juridike në funksion të shoqërisë;
- Propozuar rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme (të veçanta), ndarjen e fitimit, etj.
- Përfaqësuar apo emëruar përfaqësues në çështje gjyqësore që mund të ketë shoqëria;
- Emëruar përfaqësues duke i deleguar të gjitha ose një pjesë të kompetencave të tij.

NENI 16

KUSHTET EKONOMIKE

Shoqëria është pronare, përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Ajo vepron në regjistrin e pronës si çdo person tjetër juridik në Shqipëri, mund të blejë, të shesë, të japë në përdorim, të ngarkojë me barrë për detyrime ndaj të tretëve ose për kredi bankare, etj.

NENI 17

Shoqëria ka llogarinë e saj rrjedhëse, si dhe librin e saj të llogarive në bazë të kërkesave të ligjit për kontabilitetin e dispozitave të tjera fiskale. Transferimi i mjeteve monetare



dhe transaksionet financiare do të kryhen në bazë të kritereve të caktuara nga Banka e Shqipërisë.

NENI 18

Veprimet ekonomiko-financiare të shoqërisë nisin vitin e parë në momentin e regjistrimit në organet tatimore, ndërsa vite të tjera në Janar dhe mbyllen në 31 Dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo periudhe ushtrimore hartohet bilanci kontabël sipas ligjeve në fuqi. Bilancet periodike (mujore, tremujore e gjashtëmujore) miratohen e nënshkruhen nga Administratori i Përgjithshëm e më pas ratifikohen në asamblenë e rradhës. Bilancet vjetore miratohen nga asambleja dhe nënshkruhen nga administratorja/ Përfaqësuesja Ligjore.

NENI 19

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria i mbetet në përdorim ortakëve në përpjestim me kontributin e tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë, mbasi të jenë likujduar të gjitha detyrimet e të jetë hequr fondi i rezervës ligjore, sipas vendimeve të asamblesë.

NENI 20

Nga fitimet e realizuara gjatë vitit finciar shoqëria pasi bën zbritjen e humbjeve të vitit të mëparshëm, lë mënjane 5 % të fitimit me të cilin krijohet fondi rezervë i domosdoshëm derisa ky fond të arrijë masën 10 % të kapitalit themeltar.

NENI 21

MARRËDHËNIET E PUNËS

Marrëdhëniet e punës në këtë shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për çështjet që nuk parashikohen në to zbatohen dispozitat e Kodit të Punës në R.SH. Mosmarrëveshjet e punonjësve me shoqërinë do të zgjidhen në gjykatën shqiptare. Punonjësit e emëruar nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit të realizuar nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj, nëse në kontratë nuk është parashikuar ndryshe. Për punën e kryer punonjësit marrin pagë siç është parashikuar në kontratë.

NENI 22

DISPOZITA TË VEÇANTA

Veprimtaria e shoqërisë pushon me vendim të asamblesë për shkaqet:

- veprimtaria rezulton negative;



- pamundësi veprimi;
- shpërndahet me vullnetin e ortakëve;
- riorganizohet në një formë tjetër.

NENI 23

Bazuar edhe në nenet e sipërcituara të këtij statuti asambleja cakton një ose më shumë likujdatorë të cilët marrin në dorë drejtimin e shoqërisë duke kryer gjithë veprimet e likujdimit të saj, duke likujduar në radhë të parë detyrimet ndaj shtetit e më pas ndaj të tretëve. Në rastin e tepricës së kapitalit të shoqërisë me përfundimin e likujdimit, kjo i shpërndahet ortakëve, ndërsa në rastin e pamjaftueshmërisë së kapitalit ortakët janë të detyruar të derdhin kuotat e tyre deri në nivelin e kuotave të kapitalit themeltar.

NENI 24

Mosmarrëveshjet midis ortakëve zgjidhen me pajtim, në të kundërt palët i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 25

Shndërrimi, shpërndarja dhe prishja e shoqërisë “DEVOLLI LOGISTIC CENTER ALBANIA” sh.p.k në shoqëri të tipeve të tjera, kolektive ose në drejtim të thjeshtë, mund të bëhet me vendim të asamblesë së ortakëve.

NENI 26

Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarë do shkakut si:

- Humbja e kapitalit të shoqërisë
- Pamundësi veprimi
- Me vendim të asamblesë së ortakëve
- Në këto raste pronari i shoqërisë vendos mbi mënyrën e likujdimit dhe cakton një ose më shumë likujdatore duke ju përcaktuar dhe detyrat.
- Administratori i Përgjithshëm dhe likujdatori janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë, përderisa ajo tu dorëzohet personave përkatës fizike e juridike duke u likujduar në rradhë të parë detyrimet ndaj personave të tretë që ka shoqëria. Në rast se fondet disponibël, rezultojnë të pamjaftueshme për shlyerjen e detyrimeve të Shoqërisë likujdatori mund t'i kërkojë ortakëve themelues të shoqërisë që të derdhin tërësisht kuotat që i takojnë atij.



NENI 27

DISPOZITA TË FUNDIT

Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij statuti dhe aktit bashkëlidhur dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit Tiranë.

NENI 28

Për sa nuk është shprehur në këtë statut i referohet plotësimeve që do të bëjë asambleja si dhe ligjeve të veçanta në të cilat është referuar hartimi i këtij statuti. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij statuti bëhen në të njëjtën mënyrë e procedurë me të cilën është hartuar vetë statuti.

NENI- 29

Ky statut u përpilua në prani të ortakëve duke shprehur vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Ai u përpilua në katër kopje me fuqi të barabartë secila për t'u depozituar në QKB dhe për t'u shpërndarë në organet kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

O R T A K U

“DEVOLLI LOGISTIC SYSTEM” SH.P.K

Shkëlqim Devolli

